



Buletini nr. 158- Janar- 2017- Zyra për Informim Publik - <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>



KOMUNA E MALISHEVËS



# BULETINI

Buletini nr. 158- Janar- 2017- Zyra për Informim Publik - <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>



*Pamje nga aktivitetet e muajit janar*



## Përmbajtja:

Rrugët e hapura, por ka telashe në vendbanimet malore.....	2
Bashkësia Islame merr obligimin për kryerjen e shërbimeve të varrimit.....	3
Rrugët e hapura, por ka ngrica në rrugë.....	4
Eurodeputeti Alessandro Battilocchio qëndroi në Malishevë.....	5
Komuna dhe HANDIKOS-i në Malishevë, nënshkruajnë marrëveshjen për kryerjen e shërbimeve shtëpiake shëndetësore.....	6
Fermerët malishevas furnizohen me pesëdhjetë krerë të lopëve qumështore.....	6
Mësimi ka filluar në të gjitha shkollat e Malishevës.....	7
KPF mbajti mbledhjen e parë për këtë vit .....	8
Kërkohet bashkëpunimi i kryetarëve të fshatrave për rregullimin e emërtimeve të rrugëve ...	9
Kryetari Begaj, priti pjesëtarët e LMT-së në Malishevë.....	10
MPMS, në bashkëpunim me QPS dhe “Nëna Tereze”, shpërndau ndihma për njëqind familje .....	11
Qeveria komunale, diskuton për fillimin e projekteve të këtij viti .....	11
Hapet konkursi për bursa për student të Malishevës .....	12
Përkujtohen të vrarët në masakrën e vitit 1990 në Malishevë .....	12
KK i Malishevës, reagon kundër arrestimit të Ramush Haradinajt.....	13
KK miratoi planin e punës për vitin 2017 .....	14



## Rrugët e hapura, por ka telashe në vendbanimet malore

### Malishevë, 5 janar



Të gjitha rrugët në Komunën e Malishevës, janë të hapura, mirëpo në disa fshatra të thella malore, ka probleme për shkak të ngricave, rënies së vazhdueshme të borës dhe erërave, të cilat vende vende e bartin borën në rrugë. Nga fillimi i reshjeve rrugët kanë filluar të hapen dhe nuk ka asnjë rrugë të bllokuar.

Kështu ka bërë të ditur drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Milazim Morina, sipas të cilit kompania përgjegjëse për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë dimrit, është në terren dhe po largon borën nga rrugët, edhe pse ka reshje të vazhdueshme të borës.

Fshatrat e thella kanë më shumë probleme në rrugë, pasi sasia e borës është më e madhe dhe për shkak të specifikave të terrenit, siç janë fshatrat Llapçevë, pastaj Berisha dhe Fshati i Ri. Këto dy të fundit, kanë më shumë telashe në rrugë, për shkak të ngricave, por rrugët janë të kalueshme.

## Bashkësia Islame merr obligimin për kryerjen e shërbimeve të varrimit

### Malishevë, 5 janar

Sot, është nënshkruar marrëveshja mes Kryetarit të Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe Kryetarit të Këshillit të Bashkësisë Islame në Malishevë, Xhevat Kryeziut, për mbulimin e shpenzimeve për shërbimin e varrimit për personat e vdekur, të cilët varrosen në territorin e Komunës së Malishevës. Kjo





marrëveshje është bërë, duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-40, si dhe nenit 8 të Rregullores për Menaxhimin dhe Mirëmbajtjen e Varrezave Publike.

Bazuar në marrëveshjen e nënshkruar, Bashkësia Islame në Malishevë, obligohet të kryej shërbimet e varrimit, duke përfshirë: Regjistrimin e rastit në librin amzë të të vdekurve, hapjen e varrit, sigurimin e dërrasave, qefinin, mbishkrimin në varr, me një kosto të përgjithshme prej 200 eurove, të cilat do të mbulohen nga buxheti i Komunës së Malishevës.

Në këtë marrëveshje janë të specifikuara të gjitha shërbimet dhe standardet që duhet të përdoren, bazuar në rregulloren e miratuar në Kuvendin e Komunës së Malishevës, më 28.12.2016, ndërsa zbatimi i kësaj marrëveshje hynë në fuqi nga dita e sotme dhe zgjatë deri në fund të vitit.

## Rrugët e hapura, por ka ngrica në rrugë

### **Malishevë, 6 janar**

Të gjitha rrugët kryesore që lidhin fshatrat me qendrën komunale, janë të hapura, por ka vështirësi në qarkullim për shkak të ngricave dhe për shkak të erërave të forta, të cilat kanë bartë borën në rrugë. Gjatë gjithë natës së mbrëmshme është punuar për pastrimin e rrugëve. Ngrica ka edhe në rrugët magjistrale.

Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Milazim Morina, ka bërë të ditur se është punuar intenzivisht në largimin e borës nga rrugët, por reshjet e vazhdueshme, kanë krijuar vështirësi në qarkullim. “Në mëngjesin e sotshëm, jam në Pagarushë (fshat i thellë malor), dhe rruga kryesore është e hapur, sikur edhe në fshatrat tjerë, ndërsa gjatë natës së mbrëmshme, bashkë me kryetarin Begaj, kemi qëndruar në Berishë, ku gjithashtu rruga është e hapur dhe është punuar edhe gjatë natës në hapjen rrugëve, me gjithë vështirësitë që po sjellin temperaturat e ulëta”, ka bërë të ditur drejtori Morina.

Sipas shërbimeve publike, asnjë rrugë nuk ka qenë e mbyllur dhe asnjë fshat nuk është i izoluar, por vështirësitë janë normale, për shkak të reshjeve të vazhdueshme dhe temperaturave të ulëta.

Gjatë ditës së djeshme, me kërkesë të një qytetari, është dërguar një autoambulancë në fshatin Gollubovc, ku është bartë një pacientë për trajtim mjekësor, ndërsa edhe shërbimi i bartjes së pacientëve në dializë është kryer pas asnjë problem, sikur edhe sot që është duke u kryer ky shërbim pa asnjë problem, ndërsa pacientët janë nga vendbanime të ndryshme të komunës.



Gjatë ditës, do t'iu mbajmë të informuar për gjendjen e rrugëve në tërë territorin e Komunës së Malishevës.

## Eurodeputeti Alessandro Battilocchio qëndroi në Malishevë

### Malishevë, 9 janar



Në pasditen e vonshme të së dielës, në Komunën e Malishevës, ka qëndruar deputeti i Parlamentit Evropian, Alessandro Battilocchio, i shoqëruar nga kryetari i Komunës Tofla (komunë e Romës), Luigi Landi dhe Slavadore Orsomando, kryetar i Këshillit të Cerveterit, bashkë me zyrtar të katër komunave. Ky delegacion është pritur nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.

Qëllimi i kësaj vizite, ishte njohja mes komunave të Italisë dhe Komunës së Malishevës, shkëmbimi i përvojave, organizimi i komunave dhe mundësia e realizimit të projekteve të përbashkëta.

Pasi i ka falënderuar për vizitën, kryetari Begaj, e ka njoftuar delegacionin nga Italia, me organizimin e Komunës së Malishevës, rrjedhat e përgjithshme, popullsinë, dhe shtrirjen e Komunës së Malishevës,

Ndërsa eurodeputeti Battilocchio, pasi shprehi kënaqësinë e tij për këtë vizitë, tha se “këtu është së bashku me përfaqësues të katër komunave të Italisë dhe se janë të interesuar të njihen me organizimin e komunave, si dhe për të parë mundësitë e bashkëpunimit”.

Edhe kryetari i Komunës së Tofla, Luigi Landi, shprehi gatishmërinë për bashkëpunim të ndërsjellë dhe për realizimin e ndonjë projekti të përbashkët, përderisa e falënderoi kryetarin Begaj, për pritjen, dhe siç tha ai, “sot është e diele dhe ju jeni në punë, duke pritur një delegacion”.



Në fund të kësaj vizite, u paralajmërua realizimi edhe i një vizite tjetër, më të gjerë dhe më të gjatë në Malishevë, me qëllim të rritjes së bashkëpunimit të ndërsjellë.

## **Komuna dhe HANDIKOS-i në Malishevë, nënshkruajnë marrëveshjen për kryerjen e shërbimeve shëndetësore**

### **Malishevë, 10 janar**



Komuna e Malishevës dhe OJQ “Handikos Malishevë”, kanë nënshkruar marrëveshjen për kryerjen e shërbimeve shëndetësore shtëpiake, për personat dhe familjet në nevojë. Marrëveshja është nënshkruar nga ana e Kryetarit të Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe koordinatores së “HANDIKOS”-it në Malishevë, Feride Hoxha. Gjatë vitit të kaluar, ky projekt është realizuar në të njëjtën mënyrë dhe është treguar i suksesshëm dhe për këtë arsye, ofrimi i shërbimeve shtëpiake shëndetësore, do

të realizohet në të njëjtën mënyrë.

Kjo marrëveshje parasheh vazhdimin e ofrimit të shërbimeve ambulatorë në shtëpitë e personave dhe familjeve në gjendje të rëndë shëndetësore dhe ekonomike, personat me hemodializë dhe personave me aftësi të kufizuara, pastaj personave të moshuar dhe personave të sëmurë të cilët kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm.

Përmes kësaj, synohet rritja e ofrimit të shërbimeve shëndetësore ambulatorë dhe rritja e cilësisë së shërbimeve mjekësore për të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës, të cilët kanë nevojë për shërbime shëndetësore shtëpiake.

## **Fermerët malishevas furnizohen me pesëdhjetë krerë të lopëve qumështore**

### **Malishevë, 13 janar**



Dje dhe sot, dhjetë fermer nga Komuna e Malishevës, furnizohen me lopë qumështore, përkatësisht me nga pesë krerë lopë. Furnizimi i fermerëve me lopë qumështore, bëhet në kuadër të realizimit të projektit për përkrahjen e blegtorëve, dhe në kuadër të investimeve të përgjithshme në bujqësi.



Këta dhjetë fermer, paraprakisht janë ndihmuar nga komuna, në ndërtimin e stallave, ndërsa finalizimi i kësaj ndihme bëhet me furnizimin me lopë qumështore. Përmes kësaj ndihme, Komuna e Malishevës, synon shtimin e numrit të gjedhëve, rritjen e kapaciteteve për furnizimin e tregut me qumësht dhe produkte të qumështit dhe krijimin e vendeve të punës.

Në shpërndarjen e gjedhëve, mori pjesë edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku dhe drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Murat Hoxha, të cilët i kanë uruar fermerët përfitues të kësaj përkrahje nga ana e komunës. “Uroj që ti gëzoni dhe ta shtoni numrin e krerëve në stallat tuaja”, ju tha nënkryetari Mazreku.

Ndërsa drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë, Murat Hoxha, ka thënë se “përkrahja për bujqësinë në përgjithësi dhe e blegtorisë në veçanti, do të vazhdojë të mbetet prioritet i Komunës së Malishevës, dhe investim në këtë drejtim do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2017”. Drejtori Hoxha, ka sqaruar se ndarja e lopëve, është bërë sipas numrave, përkatësisht numrave të regjistrit që posedojnë lopët dhe kjo ka qenë forma më transparente e ndarjes së krerëve të lopëve.

Po ashtu drejtori Hoxha, ka thënë se “të gjitha këto krerë, janë të mbarësuarra dhe brenda pak kohësh, praktikisht numri i tyre do të dyfishohet nga pesëdhjetë, në njëqind krerë dhe ky është edhe synimi ynë, që përmes kësaj ndihme fermerët të kenë mundësi të rrisin kapacitetet e tyre në stalla”.

Përndryshe, furnizimi me lopë qumështore, është bërë në bashkëfinancim me fermerët, ku Komuna e Malishevës ka kontribuar me 70% të shumës, përkatësisht me 72 200 euro, ndërsa fermerët me 30% të shumës.

Gjatë vitit 2017, sipas drejtorit Hoxha, do të ketë edhe investime tjera, si në fushën e blegtorisë, ashtu edhe fushat tjera të bujqësisë.

## **Mësimi ka filluar në të gjitha shkollat e Malishevës**

**Malishevë, 16 janar**



Gjysmë vjetori i dytë i vitit shkollor 2016/2017, ka filluar në të gjitha shkollat e Komunës së Malishevës dhe nuk është regjistruar asnjë problem. Kështu ka bërë të ditur drejtori i arsimit, Avdi Morina, në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve. Me këtë rast, kryetari Begaj dhe drejtori Morina, i kanë uruar të gjithë nxënësit dhe mësimdhënësit, për fillimin e gjysmë vjetorit të dytë.

Përndryshe në mbledhjen e rregullt të qeverisë komunale, Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka kërkuar nga drejtoritë, që të jenë të gatshëm për fillimin e realizimit të projekteve të planifikuara për vitin 2017. Edhe drejtori i financave, Vesel Krasniqi, ka bërë të ditur se të gjitha drejtoritë janë të njoftuar me planifikimet buxhetore, ndërsa dha vërejtje për neglizhencë nga ana e Ministrisë së Financave, për mos alokim të mjeteve, dhe siç tha drejtori Krasniqi, “mund të ketë vonesë deri në muajin shkurt, gjë e cila do të sjellë probleme serioze për komunën”.

Gjatë javës së kaluar, sipas drejtorit për bujqësi, Murat Hoxha, ka përfunduar shpërndarja e lopëve qumështore, ndërsa drejtorja që ai drejton, është në përgatitje të realizimit të projektit për ndërtimin e tridhjetë serrave për këtë vit. Kurse drejtori i urbanizmit, Ahmet Morina, ka bërë të ditur, se drejtorja është duke bërë incizimin e rrjeteve të kanalizimeve, si dhe janë bërë përgatitjet për fillimin e realizimit të projekteve, ku në mesin e tyre janë edhe tri shkolla të reja.

Drejtori për Gjeodezi dhe Kadastër, Blerim Thaçi, ka njoftuar për raportin e punës së drejtorisë, ku sipas të dhënave të nxjerra, viti 2016 ka qenë i suksesshëm edhe në grumbullimin e të hyrave nga drejtorja, ku janë realizuar 14 mijë euro më shumë se viti paraprak.

Ndërsa drejtori i Shërbimeve Publike, Milazim Morina, ka njoftuar se gjendja e rrugëve është e mirë, ndërsa drejtorja gjatë këtij viti, do të ketë prioritet rritjen e hapësirave të gjelbëruara dhe rregullimin e ndriçimit publik edhe në vendbanime tjera.

## **KPF mbajti mbledhjen e parë për këtë vit**

### **Malishevë, 17 janar**

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), mbajti mbledhjen e parë vitin 2017, ku pas shqyrtimeve ka dhënë disa rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Kuvendi të Komunës. Mbledhja e sotme, sikur edhe mbledhjet tjera, janë drejtuar nga kryesuesi i Kuvendi të Komunës së Malishevës, Aziz Thaçi.



Pas miratimit të rendit të ditës dhe pas shqyrtimit të pikave, Komiteti për Politikë dhe Financa, ka rekomanduar për mbledhjen e ardhshme të kuvendit, draft planin e punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2017.

Po ashtu, për mbledhjen e ardhshme, me kërkesën e komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës, është rekomanduar për shqyrtim në KK edhe kjo kërkesë.

Në mbledhjen e ardhshme të KK të Malishevës, pritet të shqyrtohen edhe raporti i punës së Komisionit të Aksionarëve për vitin 2016 dhe plani i punës për vitin 2017.

## **Kërkohet bashkëpunimi i kryetarëve të fshatrave për rregullimin e emërtimeve të rrugëve**

### **Malishevë, 17 janar**



Komisioni i Kuvendit të Komunës, i formuar për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave për emërtimet e rrugëve, në kuadër të punës së tij, sot ka mbajtur një takim me kryetarët e fshatrave, me qëllim të informimit rreth këtij procesi, pas shfaqjeve të pakënaqësive për emrat e disa rrugëve në fshatrat e Komunës së Malishevës. Në këtë takim, mori pjesë edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i cili ka kërkuar angazhim të

përbashkët për zgjidhjen e të gjitha rasteve, ku ka ankesa apo ku ka gabime eventuale.

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, kërkoi ndihmën e të gjithë kryetarëve të fshatrave, në raport me komisionin e formuar për këtë çështje, me qëllim të gjetjes së zgjidhjeve më të mira të mundshme, duke respektuar ligjin dhe rregulloren për emërtimet e rrugëve. Është fat i mirë që sot e kemi këtë mundësi, dhe është fat i mirë që kemi emra të mjaftueshëm të personaliteteve tona, që mund ti emërojmë rrugët e vendbanimeve tona, prandaj, kërkoj ndihmën e juaj, që ti sqaroni të gjithë banorët, e sidomos aty ku ka pakënaqësi të shprehura dhe të gjenden zgjidhjet më të mira dhe më të pranueshme”, tha Begaj.

Kryetari i Komisionit për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve, lidhur me emërtimin e rrugëve, Rrahim Morina, tha se “ka qenë një punë e vështirë dhe e gjatë emërtimi i



rrugëve”. “Kemi shkuar në çdo vendbanim dhe kemi biseduar, por janë regjistruar edhe disa probleme, duke filluar nga insistimi i qytetarëve për vendosjen e emrave të familjarëve, pastaj papërgjegjësia e disa kryetarëve të fshatrave, gabimet në rrugë nga ana e Agjencionit Kadastral, duke mos lënë anash as gabimet eventuale që mund të ketë bërë komisioni për emërtimin e rrugëve”, tha Morina, i cili më pas edhe ju lexoi rregulloren për emërtimin e rrugëve, si dhe i ftoi kryetarët e fshatrave, që ti njoftojnë qytetarët me rregulloren dhe ligjin dhe të eliminohen të gjitha gabimet e mundshme, duke ju përkujtuar që shumë nga ankesat apo kërkesat mund të refuzohen, nëse nuk përshtaten me rregulloren.

Kryetarët e fshatrave, nga ana tjetër, kanë adresuar një varg akuzash në raport me komisionin e Kuvendit të Komunës, për emërtimin e rrugëve. Kryetarët e fshatrave, kanë akuzuar komisionin se “vet kanë lejuar që në disa raste të vendosen emrat e familjarëve, po ashtu akuzë tjetër ishte edhe mospërfillja e procesverbaleve nga takimet me banorë dhe mos marrja parasysh e propozimeve të fshatrave, e deri të akuza për ndërhyrje të ndryshme individuale, madje duke përmendur edhe emra.

I vetmi vendbanim, që nuk është regjistruar asnjë ankesë dhe që është zbatuar rregullorja njëqind për qind, është qyteti i Malishevës, ku nuk ka ankesa për asnjë emër të vendosur në rrugë.

Kryetari i këtij komisioni, Rrahim Morina, ka paralajmëruar takime në çdo fshat, për eliminimin e të gjitha problemeve, dhe ka kërkuar nga kryetarët e fshatrave, që të jenë aktiv në informimin e qytetarëve, sidomos në rastet ku ka ankesa, si dhe ka premtuar se është duke u shqyrtuar secila ankesë dhe secili propozim i bërë, lidhur me emërtimin e rrugëve.

## **Kryetari Begaj, priti pjesëtarët e LMT-së në Malishevë**

### **Malishevë, 19 janar**

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur sot, në takim të rregullt, pjesëtarët e Liaison Monitoring Team (LMT) në Malishevë, pjesë e KFOR-it, me të cilët kanë biseduar për çështje të ndryshme të bashkëpunimit mes Komunës së Malishevës dhe KFOR-it, përkatësisht LMT-së, ndërsa e kanë vlerësuar të mirë edhe situatën e sigurisë së përgjithshme.

Fillimisht, kryetari Begaj i ka uruar pjesëtarët e LMT-së, pjesë e KFOR-it zviceran në Kosovë, për një vit të ri të suksesshëm dhe vazhdimin e bashkëpunimit të mirë mes komunës dhe LMT-së, përkatësisht KFOR-it.



Ndërsa, udhëheqësi i njësisë së LMT-së, në Malishevë, kapiteni Igor Macoratti, e ka falënderuar kryetarin Begaj, për kohën e rezervuar, si dhe për tij, i ka falënderuar të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës, për mirëkuptimin dhe pritjen e ngrohtë që ju bëhet si ushtarë të KFOR-it.

Kryetari Begaj e kapiteni Macoratti, gjatë bisedimit, e kanë vlerësuar lartë bashkëpunimin e ndërsjellë, si dhe e kanë

vlerësuar të qetë situatën e sigurisë së përgjithshme në Komunën e Malishevës.

## **MPMS, në bashkëpunim me QPS dhe “Nëna Tereze”, shpërndau ndihma për njëqind familje**

### **Malishevë, 19 janar**

Sot në Malishevë, njëqind familje janë ndihmuar me pako në veshmbathje, shtrujë dhe mbulojë. Këtë ndihmë për këto familje e ka ofruar Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale në Malishevë dhe OJQ Sh.H “Nëna Tereze” në Malishevë.

Me këtë rast, nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku, i ka falënderuar zyrtarët e kësaj ministrie për këtë ndihmë, të cilën e quajti “të mirëseardhur, pasi me kjo ndihmë, është e qëlluar në këtë kohë të stinës së dimrit”.



Përndryshe, sipas drejtorit të Qendrës për Punë Sociale në Malishevë, Blerim Begaj, përfitues të kësaj ndihme, janë njëqind familje në asistencë sociale, kurse shpërndarja bëhet në bashkëpunim mes qendrës që ai drejton, ministrisë dhe shoqatës “Nëna Tereze”.



## Qeveria komunale, diskuton për fillimin e projekteve të këtij viti

### **Malishevë, 23 janar**

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, si çdo të hëne, edhe sot ka mbajtur mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, ku temë kryesore e kësaj mbledhje ishte fillimi i procedurave për realizimin e projekteve kapitale, ku u tha se projektet e mëdha, siç janë shkollat, duhet të fillojnë menjëherë.

Ndërtimi i objekteve shkollore, merr kohë më të gjatë të realizimit, prandaj edhe u tha se procedurat për realizimin e tyre, duhet të fillojnë më shpejt se procedurat për projektet tjera. Për këtë, edhe kryetari Begaj, ka kërkuar që të mos shënohet asnjë vonesë në realizimin e këtyre projekteve.

Në mbledhjen e sotme, u raportua për planifikimet e drejtorive, për aktivitetet javore dhe për aktivitetet gjatë vitit 2017. Po ashtu në këtë mbledhje, u bë e ditur, sa ministria e bujqësisë, e ka njoftuar drejtorinë e bujqësisë për fillimin e procedurave për aplikim për subvencione të qumështit.

## Hapet konkursi për bursa për student të Malishevës

### **Malishevë, 30 janar**

Drejtuar nga nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku, është mbajtur mbledhja e rregullt e Këshillit të Drejtorëve, ku është raportuar për punët dhe planifikimet e drejtorive. Në këtë mbledhje, u bë e ditur se është hapur konkursi për ndarjen e bursave për studentët e Komunës së Malishevës, për vitin 2017.

Sipas drejtorit të Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Avdi Morina, konkursi është i hapur deri më 11 shkurt 2017, dhe konkursi është hapur sipas Rregullores së Kuvendit të Komunës dhe me vendim të Kryetarit të Komunës. Drejtori Morina, bëri të ditur se do të ndahen pesëdhjetë bursa, për pesëdhjetë student të Komunës së Malishevës, të cilët studiojnë në Universitetet Publike në Republikën e Kosovës.

Përndryshe në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, edhe drejtorët e drejtorive tjera, kanë raportuar për përgatitjet e tyre për fillim e procedurave për realizimin e projekteve për këtë vit, në të gjitha sektorët ku janë planifikuar investime, sipas listës së projekteve kapitale të miratuara në Kuvendin e Komunës.



## Përkujtohen të vrarët në masakrën e vitit 1990 në Malishevë

### Malishevë, 30 janar



Sot, në Malishevë, me homazhe dhe nderime, janë përkujtuar të rënët e “Masakrës së Malishevës”, e 30 janarit të vitit 1990. Në këto homazhe dhe nderime, krahas familjarëve, morën pjesë edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku, i shoqëruar nga drejtorët e drejtorive komunale, deputeti i Kuvendit të Kosovës, z.Enver Hoti, ish kryetari i Komunës së Malishevës, në atë

kohë, z.Daut Krasniqi dhe personalitete e qytetarë të tjerë.

Më 30 janar të vitit 1990, në qendër të Malishevës, gjatë protestave popullore, për të drejtat e popullit shqiptar në Kosovë, kundër regjimit serb dhe kundër sistemit të asaj kohe, policia serbe, ka hapur zjarr mbi popullatën, ku janë vrarë Hysni Mazreku dhe Ali Kryeziu, derisa dhjetëra të tjerë janë plagosur, torturuar dhe maltretuar.

Në fjalën e rastit, për këtë ngjarje ka folur nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku, i cili, pasi nderoi dëshmorët Kryeziu e Mazreku, tha se “kjo ishte një prej ngjarjeve më të rëndësishme të asaj kohe, pasi për herë të parë, është shënuar edhe reagimi institucional ndaj sistemit”.

Komuna e Malishevës, nën drejtimin e Daut Krasniqit (ish kryetar i Komunës), në mënyrë institucionale, kanë reaguar ndaj vrasjes së qytetarëve të saj, duke kërkuar përgjegjësi për ngjarjen dhe këtë çështje e kanë ngritur në institucionet më të larta në ish Jugosllavi, dhe në organet tjera ndërkombëtare.



## **KK i Malishevës, reagon kundër arrestimit të Ramush Haradinajt**

### **Malishevë, 31 janar**

Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e saj të parë për këtë vit, përmes një deklarate, ka reaguuar ndaj arrestimit të ish kryeministrit të vendit, z.Ramush Haradinaj. Deklaratën para anëtarëve të kuvendit, e ka lexuar kryesuesi i KK të Malishevës, z.Aziz Thaçi dhe në këtë deklaratë thuhet:

Ne si Kuvendi Komunës së Malishevës, jemi të shqetësuar sikur të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, për proceset e montuara nga qeveria serbe, ndaj të gjithë ushtarëve të UCK-së. Përmes këtyre proceseve po tentohet të barazohet lufta çlirimtare e UCK-së, me gjenocidin e ushtruar mbi popullin tonë. Andaj, Kuvendi Komunal nxjerrë këtë deklaratë:

1. Kërkojmë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që përmes mekanizmave të saj, të bëjë presion në organizma ndërkombëtarë, veçanërisht organeve të drejtësisë franceze, që sa më parë ta lirojnë z.Ramush Haradinaj.
2. z.Haradinaj e ka dëshmuar në Tribunalin e Hagës, pastërtinë për veprimtarinë e tij gjatë luftës së fundit në Kosovë, ku si rezultat është shpallur i pafajshëm.
3. Gjenocidin e ushtruar ndaj popullit të Kosovës, posaçërisht gatë viteve të luftës 1998/1999, e dënuan të gjitha shtetet demokratike të botës dhe e ndëshkuan me intervenimin e NATO-s, ku një ndër shtetet më aktive ishte edhe shteti Francez.

Kuvendi i Komunal Malishevë

Më datë: 31.01.2017

Kjo deklaratë është iniciuar nga subjekti politik “NISMA”, konkretisht nga shefja e grupit të këshilltarëve, znj.Arbëresha Krasniqi.

## **KK miratoi planin e punës për vitin 2017**

### **Malishevë, 31 janar**

Kuvendi i Komunës së Malishevës, drejtuar nga kryesuesi Aziz Thaçi, ka mbajtur sot mbledhjen e parë për vitin 2017. Mbledhja e parë ka filluar me një minutë heshtje për të rënë të 30 janarit 1990, Ali Kryeziu dhe Hysni Mazreku, ndërsa më pas, KK i Malishevës, miratoi një deklaratë, të iniciuar nga shefja e anëtarëve të KK-së nga radhët e subjektit “NISMA”, Arbëresha Krasniqi,



përmes së cilës është reaguar ndaj arrestimit të ish kryeministrit të Republikës së Kosovës, z.Ramush Haradinaj.

Në këtë mbledhje, anëtarët e Kuvendit të Komunës së Malishevës, pas shqyrtimit kanë miratuar planin e punës së kuvendit për vitin 2017. Përmes këtij plani, KK ka orientimin e qartë të aktiviteteve të tyre, ku përfshihen mbledhjet dhe aktivitetet tjera. KK ka miratuar për diskutim publik edhe plotësimin dhe ndryshimin e rregullores së punës së Kuvendit të Komunës, komiteteve dhe komisioneve komunale.

Po ashtu, KK pas shqyrtimit ka miratuar emrat e propozuar për plotësimin me anëtar të komitetit për bujqësi (me pesë anëtarë) dhe plotësimin me dy anëtar të rinj të komitetit për komunitete.

KK, ka miratuar edhe kërkesën e një qytetari për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Në mbledhjen e sotme, përjashtuar pjesën e deklaratës për R.Haradinajt, anëtarët e grupit të PDK-së, nuk kanë marrë pjesë në punimet e kësaj mbledhjeje, siç u tha, “në shenjë proteste për mos vendosjen e fotografisë së presidentit në sallën e mbledhjeve të KK”.